



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 29.6.2021

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.26, DATË 22.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29 qershor 2021, shqyrtoi aktin normativ nr.26, datë 22.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator, për këtë akt normativ, z. Anastas Angjeli.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Anila Denaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit;
- Znj. Xhoana Agolli, Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit;
- Z. Gentian Opre, Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.26, datë 22.6.2021 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

- *Zhvillimet ekonomike të deritanishme dhe ato të pritshme.*

Gjatë vitit 2020 aktiviteti ekonomik në vend u tkurr më pak se pritej, si rezultat i rritjes së turizmit vendas e rajonal, mbështetjes me politika ekonomike dhe rindërtimit nga tërmeti.

Në vitin 2021 ekonomia ka filluar të rimëkëmbet, megjithëse ka ende pasiguri të konsiderueshme për shkak të pandemisë. Rritja ekonomike këtë vit parashikohet të arrijë nivelin 5.3 për qind, si rezultat i rimëkëmbjes së sektorëve të prekur nga pandemia, si dhe vijimit të aktivitetit të rindërtimit pas tërmetit. Objektivi për vitin 2021 është që deficitin primar të jetë rreth 3.8 për qind e PBB, me qëllim që të sigurohet mbështetje për ekonominë.

Politika fiskale, që po zbatohet këtë vit, ka qenë mbështetëse për ekonominë. Kjo vërehet në realizimin e treguesve kryesorë fiskalë për periudhën janar-maj 2021, si më poshtë:

- *Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit* u realizuan në masën 191.6 miliardë lekë ose 104 për qind të planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura janë rritur me 31 miliardë lekë.
- *Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit* arritën nivelin 211.9 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 97 për qind të planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime janë rreth 24.3 miliardë lekë më shumë ose 13 pikë përqindje më të larta. Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 97 për qind, ndërsa shpenzimet kapitale në masën 75.7 për qind në krahasim me planin.
- *Deficiti buxhetor* arriti nivelin 20.3 miliardë lekë, duke qenë rreth 58.6 për qind e planit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, deficitin buxhetor është rreth 6.7 miliardë lekë më i ulët.

Politika monetare ka qenë lehtësuese, duke i shërbyer nxitjes së konsumit dhe investimeve, çka do të kontribuojë më tej në rritje të punësimit e të pagave, në linjë me objektivin e inflacionit të përcaktuar nga banka. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit, ofroi stimulim e nevojshëm monetar, për të garantuar funksionimin normal të tregjeve financiare dhe për të nxitur më tej kreditimin e ekonomisë. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ofroi lehtësi të mëtejshme për bizneset dhe familjet shqiptare, nëpërmjet lehtësimit të përkohshëm dhe të targetuar të mbikëqyrjes së rregulloreve të funksionimit të sektorit bankar, moratoriumit gjashtëmujor të kësteve të kredisë dhe nxitjes së ristrukturimit të saj. Inflacioni është rritur nga

çmimet më të larta ndërkombëtare të mallrave të bursës, por ende është shumë poshtë objektivit të politikës monetare dhe presionet inflacioniste mbeten të ulëta.

- *Ndryshimet e mëparshme në ligjin për buxhetin e vitit 2021.*

Akti normativ nr.26, datë 22.6.2021 parashikon ndryshimin për herë të katërt të buxhetit të vitit 2021.

Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2021 janë paraqitur nga Këshilli i Ministrave me:

- *Aktin normativ nr.4, datë 5.2.2021, i cili ruajti të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik, duke rritur përkatësisht në të njejtën vlerë (3.42 miliardë lekë) të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit. Qëllimi i këtij akti normativ ishte financimi i nevojave shtesë të procesit zgjedhor.*
- *Aktin normativ nr.8, datë 22.3.2021, i cili mundësoi një rialokim prej 1 miliardë lekësh brenda zërave të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i këtij akti normativ ishte sigurimi i fondit të nevojshëm për blerjen e vaksinës kundër Covid-19. Akti normativ nuk ndryshoi treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë, të parashikuar në ligjin për buxhetin e vitit 2021: deficitin buxhetor, borxhin publik, të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit.*
- *Aktin normativ nr.18, datë 14.4.2021, i cili mbështeti procesin e vaksinimit, duke rritur me 2 miliardë lekë shpenzimet në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, përmes rritjes me të njejtën vlerë të të ardhurave tatimore. Ky akt normativ nuk ndryshoi nivelin e deficitit buxhetor dhe borxhit publik, të parashikuar në fillim të vitit. (Deficiti buxhetor mbeti 6.5 për qind e PBB, ndërsa borxhi publik 78.6 për qind e PBB. Këta tregues janë parashikuar kundrejt rritjes ekonomike prej 5.5 për qind.)*

- *Përmbajtja e aktit normativ nr.26, datë 22.6.2021.*

Akti normativ nr.26, datë 22.6.2021 ka qëllim mbështetjen e procesit të vaksinimit kundër pandemisë COVID-19, për të arritur imunizimin e të gjithë popullsisë. Gjithashtu, ai synon edhe zbatimin e disa projekteve e politikave prioritare të zhvillimit ekonomik të vendit.

Konkretisht, akti normativ parashikon këto ndryshime në buxhetin e vitit 2021:

- *Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit nuk ndryshojnë, as në total, as sipas llojit të tyre. Kjo për arsye se ecuria e të ardhurave gjatë 6-mujorit të parë ishte pozitive dhe e tillë pritet të jetë edhe pritshmëria në nivel vjetor.*

- *Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit* rriten me 11.8 miliardë lekë, nga të cilat:
 - *Shpenzimet korrente* rriten me 1 miliardë lekë;
 - *Shpenzimet kapitale* rriten me 8.8 miliardë lekë;
 - *Deficiti buxhetor* rritet në të njëjtën masë me rritjen e shpenzimeve, 11.8 miliardë lekë.

Në shpenzimet korrente bëhen këto ndryshime:

- Shtohen me 2 miliardë lekë shpenzimet për fondin rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim financimin e shpenzimeve për:
 - Fushatën e vaksinimit kundër pandemisë COVID-19, në masën 1 miliardë lekë. Ky fond është siguruar nga rialokimi i fondit në të njëjtën masë, por të papërdorur, që ishte planifikuar për skemën e rimbursimit të kurimit në shtëpi për COVID-19;
 - Projektin prioritar të Ministrisë së Mbrojtjes për pajisjen me drone, në vlerën 1 miliardë lekë, në kuadër të marrëveshjes me Turqinë dhe masave për rritjen e kontrollit të territorit dhe sigurisë kombëtare në tërësi.
- Shtohen me 1 miliardë lekë shpenzimet për AKSHI-n, me qëllim financimin e nevojave për mirëmbajtjen e sistemeve IT;
- Shtohen me 900 milionë lekë shpenzimet si transfertë specifike për Bashkinë Tiranë, për ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar;
- Shtohen me 500 milionë lekë shpenzimet për financimin shtesë të nevojave të qerave të strehimit social;
- Shtohen me 200 milionë lekë shpenzimet për mbulimin e ngritjes dhe funksionimit të grupit të përfaqësuesve në Këshillin e Sigurimit të OKB.

Shtesa e shpenzimeve kapitale do të përdoret në destinacionet si më poshtë:

- 4.8 miliardë lekë shtohen për projektet në infrastrukturë, në programin “Transporti Rrugor”, të cilat kanë avancuar me punimet mbi planin buxhetor të miratuar për vitin buxhetor 2021. Këto fonde do të destinohen në disa projekte, si:
 - Hapja e loteve të reja për “Ndërtimin e segmentit rrugor Unaza Veriore, Tiranë”,
 - Ndërtimi i segmentit rrugor “Sheshi Shqiponja-Bulevardi i ri”;
 - Projektet aktuale Unazës së Tiranës.

- 3 miliardë lekë shtohen për projektet në vazhdim të programeve të zhvillimit.
 - 2.5 miliardë lekë shtohen për projektet në vazhdim për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve në shkallë vendi, për përmiresimin e furnizimit me ujë të popullsisë.
 - 1 miliardë lekë shtohen për projektin në vazhdim, me financim të huaj, “Ndërtim By-Pass i Vlorës”, i cili ka ecuri të mirë dhe pritet të tejkalojë realizimin e miratuar për këtë vit.
 - 1 miliardë lekë shtohen për projektin në vazhdim me financim të huaj “IPARD II”, bazuar në ecurinë e mirë dhe pritshmëritë për realizimin e tij;
 - 0.2 miliardë lekë shtohen për godinën e Polit të Drejtësisë, bazuar në kështet e përcaktuara në kontratën përkatëse.
- *Nevoja për aktin normativ.*

Akti normativ nr.26, datë 22.6.2021 mbështetet në prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Vaksinimit në vendin tonë për të arritur imunizimin e të gjithë popullsisë kundër pandemisë Covid-19. Kjo Strategji ka objektiv vaksinimin e 2.2 milionë personave, për të cilët nevojiten 4.4 milionë doza vaksinash.

Deri sot, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nënshkruar kontrata për sigurimin e 2.9 milionë dozave të vaksinës, nga të cilat:

- 1.2 milionë doza, nga kontrata COVAX, për një periudhë 3-vjeçare;
- 1.6 milionë doza nga kontrata që përfundojnë kryesisht brenda vitit 2021;
- 0.2 milionë doza janë donacione.

Për përmbushjen e objektivit, nevojiten edhe 1.1 milionë doza të tjera vaksinash. Për këtë arsye, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale paraqiti kërkesën për shtesën e buxhetit me 1 miliardë lekë.

Përveç këtij ndryshimi, akti normativ parashikon edhe disa ndryshime të tjera në buxhetin e vitit 2021, nga të cilat një pjesë janë rialokime pa kosto shtesë, ndërsa pjesa tjetër janë financime për disa politika prioritare. Këto ndryshime janë bërë të nevojshme pas analizës së realizimit të planit për periudhën 6-mujore të vitit 2021 dhe përcaktimit të objektivave deri në fund të vitit.

- *Paraqitja e ndryshimit buxhetor me akt normativ.*

Ndryshimi i buxhetit përmes aktit normativ është një praktikë e ndjekur prej vitesh, kur plotësohen kërkesat e nenit 101 të Kushtetutës, si dhe të vendimeve nr.24, datë 10.12.2006 dhe nr.23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Në rastin konkret, ndryshimet në buxhetin vjetor janë të nevojshme dhe emergjente për të vijuar procesin e vaksinimit të plotë të popullsisë në vendin tonë, për të mundësuar financimin e disa politikave prioritare, si dhe të disa projekteve shumë të rëndësishme të transportit rrugor, ujësjellës-kanalizimeve etj.

Ndryshimi buxhetor plotëson edhe kriterin kushtetues të përkohshmërisë, pasi akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh. Pas këtij afati, akti normativ duhet të miratohet nga Kuvendi, që të marrë fuqinë e ligjit.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti aktin normativ, duke u ndalur në realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë gjatë periudhës së 5-mujore dhe parashikimin për realizimin e pritshëm të tyre deri në fund të vitit. Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, znj. Denaj theksoi se vendi do të vazhdojë t'i nënshtrohet konsolidimit fiskal edhe për një periudhë afatmesme 4-5 vjeçare, për të stimuluar zhvillimin e ekonomisë. Për këtë qëllim, vëmendje e posaçme do t'i kushtohet mbledhjes së të ardhurave. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar një Strategji Afatmesme për të Ardhurat, të cilën po e rishikon në situatën e post pandemisë. Vënia në zbatim e procesit të fiskalizimit do të japë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e të ardhurave dhe vendosjen e konkurrencës së ndershme ndaj biznesit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe rimbursimit të TVSH ndaj biznesit për projektet me financim të huaj, për të çuar drejt zeros stokun e TVSH së parimbursueshme.

Z. Anastas Angjeli, në cilësinë e relatorit, theksoi se ndryshimet buxhetore, të parashikuara në aktin normativ, janë të domosdoshme, për të vijuar dhe realizuar plotësisht procesin e vaksinimit të popullsisë dhe për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve. Gjithashtu, këto ndryshime mundësojnë zbatimin e disa projekteve prioritare të vendit, në fushën e teknologjisë së informacionit, strehimit social, si dhe të pjesëmarrjes së vendit në Këshillin e Sigurimit të OKB. Ndryshimet buxhetore mundësojnë edhe financimin e disa projekteve shumë të rëndësishme të transportit rrugor, ujësjellës-kanalizimeve, zhvillimit ekonomik, sistemit të drejtësisë etj. Këto ndryshime janë në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe me prioritetet strategjike të vendit.

Në përfundim të fjalës së tij, relatori paraqiti disa rekomandime për masat që duhet të ndërmerren strukturat ekzekutive, në gjysmën e dytë të vitit, për të siguruar realizimin e objektivave të parashikuara. Këto rekomandime, të cilat u mbështetën nga anëtarët e Komisionit, janë si më poshtë:

Së pari, politikat ekonomike për pjesën e mbetur të vitit e më tej, duhet të vazhdojnë të jenë stimuluese, për të mbështetur rimëkëmbjen dhe rritjen ekonomike të vendit. Forcimi i qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike duhet të shoqërohet me politikat e forcimit të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit.

Së dyti, rritja e të ardhurave mbetet një objektiv i rëndësishëm, për të mbështetur rritjen e shpenzimeve dhe për të arritur konsolidimin fiskal në periudhën afatmesme, me qëllim që të ndërtohet hapësira e nevojshme për politikën fiskale. Në këtë kuadër, duhet të përfundojë e të fillojë nga zbatimi së më parë i strategjisë afatmesme për të ardhurat, e cila do të krijojë kornizën e nevojshme në fushën e mbledhjes së të ardhurave, me qëllim që të arrihen objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Së treti, përmirësimi i menaxhimit të investimeve publike dhe të shpenzimeve buxhetore në përgjithësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes së të gjitha institucioneve buxhetore, për të mbështetur rritjen ekonomike dhe konsolidimin fiskal.

Së katërti, përshpejtimi i axhendës së reformave strukturore duhet të vijojë e të thellohet më tej, për të arritur forcimin afatgjatë të qëndrueshmërisë së financave publike dhe rritjen më të shpejtë të ekonomisë së vendit.

Së pesti, duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për përmirësimin e klimës së biznesit, përmes rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë së strukturave shtetërore, forcimit të konkurrueshmërisë, thjeshtimit të procedurave, si dhe thellimit të luftës kundër korrupsionit. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim ka respektimi me rigorozitet i rregullave të prokurimit publik dhe shmangja e procedurave të kufizuara në prokurime.

Së gjashti, monitorimi i risqeve fiskale, veçanërisht nga partneriteti publik privat, ndërmarrjet shtetërore dhe garancitë qeveritare është një detyrim i rëndësishëm që duhet të forcohet më tej.

Së shtati, fondet e rindërtimit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të vazhdueshme të menaxhimit të financave publike dhe t'i nënshtrohen procedurave efikase ligjore të prokurimit publik.

VI. Përfundim.

Mbështetur në argumentet dhe rekomandimet e cituara më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.26, datë 22.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

KRYETARI

Anastas ANGJELI